

V E N D I M
Nr.360, datë 4.8.1999

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.805, DATË 24.12.1998 “PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE NGA SHOQËRIA
NË ADMINISTRIM “FABIONA” SHPK, TË PËRNDJEKURVE POLITIKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga populli i gjerë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.805, datë 24.12.1998 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon si vijon:

“Shlyerja e kreditorëve të përndjekur politikë për letrat me vlerë, të grumbulluara nga shoqëria “Fabiona” shpk, në administrim, të vazhdojnë deri në fund të muajit qershor të vitit 2000, duke respektuar kuotat fikse për çdo 3-mujor, sipas planbiznesit të hartuar.”

2. Në fund të pikës 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Nga fondi i amortizimit, që do të krijohet për shoqërinë “Fabiona” shpk, në administrim, për vitin 1999 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2000, në zbatim të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, jo më pak se 50 për qind e tij (tepricë amortizimi), të përdoret për shlyerjen e kreditorëve të përndjekur politikë.”

2. Pika 5 ndryshon si vijon:

“Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit, brenda muajit gusht të vitit 1999, për shoqërinë “Fabiona”, shpk, në administrim, përfaqësuar nga fituesi i ankandit, të organizojë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.283, datë 18.6.1999, shitjen me rezervë, me afat kohe 10 vjet, me kuotë fikse për çdo vit, sipas vlerës së ankandit të fituar. Llogaritja dhe derdhja e kuotave fikse në buxhetin e shtetit, të vlerës së ankandit, të fillojë pas shlyerjes së kreditorëve të përndjekur politikë në fund të muajit qershor të vitit 2000.”

3. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“Në fund të çdo 3-mujori, deri në përfundim të shlyerjes së kreditorëve të përndjekur politikë, administratori të ndjekë realizimin e treguesve financiarë sipas planbiznesit, duke mos lejuar asnjë shmangie të tyre dhe të informojë në vazhdimësi për këto probleme Grupin Mbikëqyrës dhe Këshillin e Ministrave.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko